



KOLANA

BOTË NË PËRKTHIM

Pikëtakim i kulturave europiane në gjuhën shqipe

IRIS HANIKA

THELBËSORJA
NË JETË

ROMAN

Përktheu nga origjinali gjermanisht:
Shpëtim Çuçka

BOTIMET TOENA
Tiranë, janar 2016

Iris Hanika, Das Eigentliche



Ky projekt u realizua me mbështetjen e Programit
“Europa Krijuese” të Komisionit European.

Ky botim pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit.
Komisioni European nuk mund të konsiderohet përgjegjës për
informacionin që përmban teksti dhe mënyrën e përdorimit të
tij.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Redaktore: Anrila Spahija
Korrektore letrare: Besa Besnike Vila
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Albana Kuraj Gega

ISBN 978-9928-205-42-1

© Literaturverlag Droschl, Graz - Wien 2010

© Botimet Toena, 2016

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që
përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen
me shkrim të Botimeve Toena.

Botimet TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

“Ne jemi vërtet të shëmtuar, por kemi muzikën që na zbukuron.”

Leonard Cohen,
Chelsea Hotel #2



VJEN NJË KOHË, kur njeriun e lënë të gjitha, edhe rrëmbimi i viteve të rinisë, edhe hidhërimi për shkak të padrejtësisë së kësaj bote, madje edhe besimi se gjendja do të mund të bëhej më mirë, për të mos thënë fare mirë, sikur njerëzit të përpiqeshin për këtë sadopak dhe me gjithë zemër. Vjen një kohë, kur kjo zemër ndihet tërësisht e zbrazët dhe njeriu, i zmbrapsur nga gjithçka, e gjen veten fare fillikat. Kjo është një kohë aspak e bukur.



NDONJËHERË ATIJ I KUJTOHEJ SE SI DIKUR, kur i qëllonte të hipte në një tren metroje të mbushur plot e përplot me udhëtarë, gjithnjë mendonte se trenat që ishin nisur për në kampet e përqendrimit ose të shfarosjes kishin qenë të mbushur ku e ku më shumë sesa treni, në të cilin ai kishte hipur, dhe se në të dyja anët e vagonit nuk kishte pasur as edhe një stol për t'u ulur. Te kjo përjasje e kishte udhëhequr Graciela, kur i kishte treguar se një kapërcim të tillë nga jeta e përditshme tek e kaluara, nga metroja tek Aushvici, e kishte ndeshur në filmin amerikan "Nëpunësi i dyqanit të pengut" (viti 1964, regjisor Sidni Ljumet) dhe se që atëherë një përjasje e tillë nuk i dilte më nga mendja. Megjithatë, kishte vazhduar ajo, ky mendim i shkaktonte një lloj neverie në vetvete dhe kjo ndodhte për dy arsye: nga njëra anë asaj i dukej një lloj mendjemadhësie të përqaste në çfarëdolloj mënyre kushtet e jashtme të jetesës së saj, të cilat ishin nga çdo pikëpamje tërësisht të këndshme dhe të denja për njeriun, me kushtet e një të kaluare të braktisur nga qytetërimi. Gjithsesi fjala "mendjemadhësi" ishte e pasaktë, pasi ishte tepër e varfër. Ndoshta më e goditur do të ishte sipas saj fjala "pacipësi", madje edhe fjala "paturpësi" do të shkonte për bukuri në këtë rast. E prapëseprapë edhe ajo do të ishte e dobët, krejtësisht e dobët, shumë e dobët. Ndoshta fjala "ndyrësi", kjo po që do të ishte fjala e duhur. Por fakti që ajo vetë kishte për më tepër volinë të kërkonte fjalën e duhur, kishte kohën dhe lehtësinë e nevojshme për t'u marrë me një gjë të tillë, kishte kohë dhe hapësirë për të menduar



dhe mendje për të dhënë gjykim, të gjitha këto ia bënin asaj edhe më të fortë neverinë dhe kjo ishte arsyeja e dytë. Atëherë ai kishte menduar se fjala “ndyrësi” ishte tanimë shumë e shpërdoruar. Sipas tij fjala “papërgjegjshmëri” ishte shumë më e mirë. Por ai nuk fliste, vetëm vijonte të dëgjonte Gracielen, e cila i shpjegonte se veç kësaj ky film nuk trajtonte thjesht jetën e dikujt, që ishte kriminel lufte dhe kishte një mbesë, sikurse ishte edhe rasti i saj (ndonëse, siç e dinte ai, ngaqë ajo i kishte folur me hollësi për këtë, në familjen e saj nuk kishte pasur asnjë kriminel lufte të mirëfilltë, asnjë anëtar të partisë naziste, por vetëm një gjysh, i cili e shumta, po të gjykohej çështja me rreptësi, mund të cilësohej si bashkëpunëtor në krim dhe që si oficer njëzetedyjeçar ushtrie dhe komandant kompanie i armatës VI, kishte mundur të shpëtonte nga beteja e Stalingradit vetëm e vetëm sepse, pak para se të mbërrinte në qytet dhe pasi kishte marrë pjesë më parë në sulmin mbi aeroportin e Rostovit, ishte plagosur rëndë në kokë ose, thënë ndryshe, kishte fituar medaljen “Për mbrojtjen e atdheut”, gjë që i siguroi kthimin nga fusha e betejës në një spital në Hungari dhe pas shërimit i mundësoi lirim nga shërbimi i mëtejshëm në luftë [pas pushtimit të qytetit të Rostovit aty u bë një pushkatim masiv, në të cilin u vra edhe Sabina Shpilrajni së bashku me dy të bijat; gjyshi i Gracielës në të vërtetë nuk bënte pjesë në grupet speciale dhe nuk kishte marrë pjesë në atë pushkatim, mirëpo kishte ndihmuar për



pushtimin e Rostovit dhe, për pasojë, ndaj tij u ngrit një padi për vrasjen e Sabina Shpilrajnit; edhe për këtë temë ata kishin biseduar gjerë e gjatë: sesi mund ta përballonte njeriu këtë, a mund të durohej diçka e tillë]). Në të vërtetë filmi “Nëpunësi i dyqanit të pengut” trajtonte edhe një figurë krejt tjetër, pikërisht atë të një njeriu (të Sol Nazermanit, luajtur nga Rod Shtajgeri [në vitin 1966 për këtë rol ai u përfshi në listën e kandidatëve për çmimin ‘Oskar’ për rolet kryesore së bashku me Lorens Olivierin tek “Otelloja”, Oskar Vernerin në filmin “Anija e budallenjve”, Riçard Bartonin në filmin “Spiuni që erdhi nga viset e ftohta” dhe Li Marvinin në filmin “Maçoku Bajun”, çmim të cilin e fitoi ky i fundit]), i cili me të drejtë ndihet fajtor që mbeti gjallë. Ishte thjesht tabloja e një filmi, që ajo nuk mundej ta harronte dhe që, sa herë udhëtonte në trenin e metrosë mbushur plot me njerëz, i shfaqej menjëherë përpara syve.

Duke i folur për filmin, ajo ia kishte futur në shpirt edhe atij këtë tablo. Ai, nga ana e tij, kishte shkuar në arkivin e teatrit dhe kishte huajtur një kopje të filmit “Nëpunësi i dyqanit të pengut” për ta parë edhe një herë në videon e institutit. Që atëherë edhe ai kishte nisur ta ndiente veten shumë keq nëpër trenat e stërmbushur të metrosë.

Mirëpo tani, kur e sillte ndër mend këtë tablo, nuk e kishte më atë ndjenjën e angështisë dhe, për më tepër, nuk i vinte turp nga kjo. Dikur me siguri do të ishte turpëruar nga një mungesë e tillë e ndjenjës së turpfit.



Por tani jo më.

Tani mund të udhëtonte nëpër trenat e metrosë mbushur me udhëtarë ose të mendonte për mjetet e transportit publik pa u ndier ligsht, sikurse i kishte ndodhur më parë. Tani mund t'i shihte mësh teknat dhe kjo të mos i sillte ndër mend vendin e quajtur Birkenau. E ndërkaq kjo nuk bënte që t'i dukej vetja një njeri i ftohtë e pa ndjenja.

Dikur kishte pasur shumë frikë nga një pandjeshmëri e tillë dhe ishte ruajtur shumë që të mos i binte në sy asaj për këtë. Ai e kishte mbajtur vazhdimisht nën vëzhgim e nën kontroll ndjeshmërinë e vet dhe nuk kishte dalluar asnjëherë ndonjë çast përgjumjeje të kujtesës.



BRENDA ÇDO KËNGE KA NJË AUSHVIC,
te çdo pemë, te çdo kaçubë.
Brenda çdo kënge ka një Aushvic
dhe po ashtu te çdo gjerman.

Tra-la-la, tra-la-la, trala-trala-trala.



TANI AI ISHTE MËSUAR ME FATIN E TIJ TË KEQ. (Falë faktit që kishte lindur vonë, ha-ha-ha.)

Me fatin e tij të keq ai ishte mësuar.

Tra-la-la, tra-la-la, trala-trala-trala.

Se kur i kishte lindur kjo shprehi e të mësuarit me fatin e keq, këtë nuk dinte ta thoshte Kishte shumë të ngjarë që kjo të kishte ndodhur, kur i kishte kapërcyer të tridhjetat. Dhe që atëherë nuk i ishte ndarë më. Ndoshta i ishte shfaqur për herë të parë, kur ishte shpallur njoftimi për shërbimin publik. Befas kishte kuptuar që tani nuk ushqente më shpresën se ky fat i keq do të merrte fund një ditë dhe prej shumë kohësh nuk kishte ndërmarrë ndonjë përpjekje për t'i dhënë fund atij. Fati i keq ishte diçka reale, ashtu si ishte edhe ai vetë. Ishte diçka që i përkiste atij. Dhe sa herë që mendonte për veten, nuk e përfytyronte dot të palidhur me fatin e keq. Gjithë jeta e tij në mënyrë fare të vetëkuptueshme ishte e përfshirë në gjirin e këtij fati të keq. Disa njerëz jetojnë në fshat, disa të tjerë në qytet, ca i kanë flokët në ngjyrë të errët, ca i kanë në ngjyrë të çelët, disa jetojnë të lumtur, disa të tjerë janë të palumtur. Gjithçka ishte fare e thjeshtë. Ai bënte pjesë në mënyrë të pandryshueshme në radhët e atyre që ishin të palumtur.

Dikur ai edhe do të kishte qeshur me një gjë të tillë. Se ishte vërtet për të qeshur që nuk i ecte fare, që ishte gjithnjë kaq i ngathët, që edhe për gjërat më të vogla rrinte e vriste mendjen me ditë të tëra, që asnjë grua nuk shfaqte interesim



për të, që nuk dinte të çlirohej nga huqet e tij të ndryshme, që pothuaj gjithnjë e shpërfillnin e kështu me radhë. Gjatë ditëve të punës të tjerët e vinin në lojë dhe e thumbonin, gjë që nuk ishte aspak e këndshme, përkundrazi ishte shumë brengosëse. Dhe pikërisht kjo anë e fatit të tij të keq, që ishte vërtet jo e këndshme, por gjithsesi për të qeshur, tani e kishte braktisur. Pa dyshim më parë fati i tij i keq kishte qenë për të në njëfarë mënyre diçka e prekshme, diçka konkrete. Për sa kohë që ai kishte besuar se fati i tij e kishte zanafillën vetëm tek Aushvici, ky fat kishte pasur për të një përmbajtje të caktuar. Asokohe arsyeja e fatit të tij të keq nuk kishte qenë vetëm fakti që në botë ekzistonte diçka e tillë, Aushvici, vetëm fakti që ky kishte ekzistuar. Përkundrazi ai vazhdimisht kishte menduar rreth asaj se çfarë kishte pasur mundësi të bënte ai vetë dhe çfarë nuk kishin pasur mundësi të bënin të burgosurit e Aushvicit ose rreth asaj se diçka e caktuar mund të kishte pasur për ta një domethënie krejt të ndryshme nga ç'mund të kishte për atë vetë. Sa herë që shtrihej në krevat, mendonte se ata, për shembull, nuk mund të shtriheshin në krevat atëherë kur dëshironin. Po kështu, sa herë që shtrihej në krevat, kishte menduar aty për aty se ata nuk kishin krevat, por një shtrat të thjeshtë, për më tepër secili prej tyre nuk kishte një shtrat më vete, ndërkohë që ai as atëherë dhe as sot nuk ishte në gjendje të thoshte se kur kishte qenë hera e fundit, që nuk kishte fjetur i vetëm në krevat. Po kështu,



sa herë që kishte shkuar në banjë, kishte menduar se ata nuk kishin pasur mundësinë të shkonin në nevojtoje kur duhej, por vetëm në një kohë të paracaktuar, e cila për më tepër ishte shumë e kufizuar, gjë që e bënte sikletin e tyre dy herë më të madh. Edhe kur gjendej në dush, mendonte se ata, pasi kishin mbërritur në kamp dhe i kishin shpënë menjëherë në “saunë”, kishin vënë re që nuk mund ta rregullonin vetë temperaturën e ujit të dushit, por ishin të detyruar të duronin rrjedhjen e ujit një herë shumë të nxehtë dhe më pas akull të ftohtë.

Ja kështu.

Për një kohë të gjatë krahasimi me Aushvicin kishte qenë për të një nevojë konkrete. Dhe pikërisht kjo nevojë e kishte rritur një krahasim të tillë deri në atë pikë, sa e kishte bërë aq të paarsyeshëm. E megjithatë kjo brengë ishte larguar dikur prej tij. Por gjithsesi ai vijoi të punonte në vreshtin e kujtesës: ndoshta ia vlente. Gjithsesi ai vijoi të bënte si edhe më parë gjithçka që mundej për t’i lehtësuar ata që kishin mbetur gjallë nga frika e tyre më e madhe: se mos vuajtja e tyre përsëritej, se mos edhe njerëz të tjerë pësonin po ato që u kishin ndodhur atyre.

Ndërkaq, ai nuk shihte më asnjë arsye për një frikë të tillë. Së paku jo në Gjermani.

Atë vërtet e pushtonte ende në ndonjë rast një urrejtje e dëshpëruar për Gjermaninë, por gjithnjë i kalonte aty për aty. Një urrejtje e tillë kishte lidhje edhe me karakterin kombëtar



dhe Hans Frambahu nuk ishte më pak gjerman se të tjerët, ndonëse nuk ishte në gjendje të saktësonte se ç'do të thoshte në thelb të jesh gjerman (le të krahasohet me librin “Ç’është gjermani” të Valter Abishit, botuar në vitet 1979, 1980 dhe 1982). Gjatë këtyre krizave të urrejtjes atij i dukej sikur befaz ishte bërë përsëri i ri. Dhe pikërisht kjo ishte ana e përbindshme e këtyre krizave: kjo ndjenjë mbytëse se befaz mund të bëhej përsëri i ri dhe të ishte përsëri i mbushur plotësisht me urrejtje të drejtë, të pastër. Jo, ai nuk dëshironte më aspak të ishte edhe një herë i ri. Përkundrazi, ishte shumë i lumtur që e kishte lënë prapa të paktën gjysmën e jetës së vet.

Në përgjithësi atij nuk i bëhej vonë për Gjermaninë, domethënë për atë Gjermani, ku shkonte jetën e përditshme.

Dhe kishte mësuar ta ndante këtë Gjermani nga Gjermania në të cilën punonte përditë.

Në Gjermaninë e tij çdo gjë i dukej më së miri. Në të punonin në rregull të gjitha institucionet publike, askush nuk vuante nga uria, qarkullimi i mallrave rridhte plotësisht si në vaj dhe, po të ishte fjala për korrupsionin, ky ndeshej vetëm në shtresat e shefave, por jo në Gjermaninë e tij të përditshme, ku nuk ishte e mundur të thyeje me para as policët e as mjekët.

E çfarë mund të kërkojë më tepër njeriu në jetë?

Dhe iu desh të kalonte shumë kohë, përpara se të bëhej i vetëdijshëm se e donte këtë vend ku jetonte. Më parë një gjë e tillë do t'i ishte dukur si tradhti.



Pyetjes se përse punonte pikërisht në Institutin e Ruajtjes së Kujtimit të së Kaluarës dhe jo në një arkiv më të këndshëm do t'i ishte përgjigjur - dikur ashtu si dhe sot - se e bënte këtë për njerëzit e mbetur gjallë, e bënte për ato plaka dhe ata pleq me zgavrat e syve të thella si pus, brenda të cilave njeriu nuk arrinte dot të zbriste me shikim, madje as nuk guxonte ta bënte një gjë të tillë. E megjithatë këta njerëz i dukeshin aq të mbushur me dëshirë për jetën, sa në krahasim me ta i dukej vetja si kufomë.

Natyrisht ai e kishte më se të qartë që kishte edhe nga ata të mbijetuar, të cilët pas jetës në kamp nuk kishin mundur të ruanin kurrfarë dëshirë për jetën.

Kur binte fjala për këta, të tjerët flisnin si për një të kaluar të marrë fund, pasi shumica ndërkohë nuk ishin më në jetë. Edhe ata që ishin ende gjallë, nuk dëshironin fare të kishin punë me institutin ku punonte ai, ose me institucione të tjera kushtuar kujtesës së krimeve të luftës. Por edhe numri i këtyre të tjerëve sa vinte e zvogëlohej.

Të thuash të vërtetën, askush nuk e kishte pyetur se përse ai bënte pikërisht këtë punë dhe asnjë tjetër.

Më parë njerëzit zbeheshin në fytyrë dhe e qepnin gojën, kur ai i përgjigjej pyetjes së tyre se ku punonte, ndërsa sot ata tundnin kokën në shenjë miratimi, sikur puna e tij të ishte më e natyrshmja që mund të bëhej.

Çështje e ruajtjes së kujtimit të së kaluarës. Fare e qartë!

Dhe njëloj si dikur edhe sot ndërronin bisedë.



Edhe ai sot kishte ndryshuar temë.

Së paku kishte përshtypjen se e kishte ndryshuar atë.

Shkonte çdo ditë në arkiv. Atje kryente punën, plotësonte detyrën.

Ishte i vetëdijshëm se ushtarakët e shërbimit të rojës në kampet e përqendrimit do të kishin dhënë po atë përgjigje, sikur t'i kishte pyetur kush se përse bënë pikërisht atë punë dhe asnjë tjetër. Me siguri atyre u kishin treguar se të ishe gjerman do të thoshte të kryeje diçka për hir të vetvetes (*Dhe këtu lindte në vetëdije dhe gjente shprehjen e vet të përcaktuar ajo se çfarë do të thoshte të ishe gjerman. Konkretisht: ajo që njeriu bën për hir të vetvetes dhe për hir të gëzimit. Ndërkaq thelbi i leverdisshmërisë, domethënë parimi, sipas të cilit një gjë kryhet për hir të një qëllimi tërësisht vetjak, shfaqet si tipar jo gjerman. Rikard Wagner, "Arti gjerman dhe politika gjermane", Lajpcig, Sh. B. e J. J. Veberit, 1868, f. 82).* Por veç kësaj atë e kanë mësuar të gjurmojë në mënyrë kritike zanafillën e çdo gjëje dhe para së gjithash të thelbit të të qenit gjerman. (Por atij nuk i kishin treguar se në këtë citat flitej edhe për gëzimin.) Kështu, pra, vetë shqetësimi kishte sjellë humbjen e shqetësimit, pasi kur ai kishte hetuar në mënyrë kritike zanafillën e shqetësimit, kishte kuptuar se ajo ishte një formë e tillë e të qenit gjerman, që krijonte urrejtjen e vetvetes. Ai ishte bërë anëtar i shërbimit të rojës dhe kjo nuk e turbullonte më. *Po treten, po zhdruken / njerëzit që vuajnë* (Fridrih Hëlderlin, "Hiperioni ose eremiti në Greqi", v.



II, libri 2. [Hiperioni në të kremten e Shën Belarminos, “Kënga e fatit të Hiperionit”]). Fati i tij i keq qëndronte tani pikërisht në faktin që nuk kishte më mundësinë ta lidhte këtë fat me asgjë të prekshme. Dhe ai u pajtua me këtë.

Fati i keq ishte diçka po aq e natyrshme, sa edhe nevoja për të marrë frymë, dhe ishte më i madh se ai vetë, pakrahasueshmërisht më i madh. E megjithatë fati i keq varej tërësisht prej atij vetë, sepse po të mos ishte ai (kështu e përfytyronte ai veten në çaste krahasimisht të gëzuara), atëherë fati i keq nuk do të kishte me se të ushqej dhe të mbahej gjallë. Në të vërtetë e kishte të qartë se fati i keq nuk donte t’ia dinte për të dhe se ishte aq i madh, sa ç’ishte, pavarësisht prej vullnetit të tij. Dhe, në rast se fati i keq nuk do të ishte, atëherë nuk do të ishte as ai vetë. Ai jetonte vetëm i kredhur në fatin e tij të keq dhe në saje të tij. Po të mos ishte fati i keq, ai nuk do të mund të thoshte me saktësi për vete se çfarë ishte. Fati i keq nuk ishte aspak i tij, nuk i përkiste realisht aspak. Ai nuk ishte fati i tij i keq, por thjesht fati i keq.

Dhe kur ai e hoqi këtë fat të keq nga vetja, atëherë prej vetë atij nuk mbeti më gjë, nuk mbeti asgjë. Nuk mbeti gjë prej gjëje. (Ai ishte tërësisht i vetëdijshëm për këtë. Por kjo nuk kishte pikë vlere.)



KUR SILLTE SOT NDËR MEND GRACIELËN, pyeste me vete se ç'bënte ajo ndërkohë, a mendonte ende, kur ndodhej në trenat e metrosë mbushur plot udhëtarë, për transportimin e njerëzve me vagonët e bagëtisë drejt fjetoreve, të cilat ishin parashikuar si stalla kuajsh për ushtrinë. Sa herë i binte ndër mend kjo gjë vendoste ta pyeste Gracielen, por pastaj rregullisht harronte. Tani ata e përmendnin rrallë Aushvicin, por edhe në këto raste nuk e përmendnin më si dikur, domethënë jo më me atë ndjesinë e një lëmshi në fyt dhe me përshtypjen se ndodheshin në fundin e një gremine, porse në një mënyrë fare të ftohtë.

Gjithsesi, ata tani takoheshin shumë më rrallë se dikur.



JAVË E RE, FAT I KEQ, I VJETËR. Ai u ngjit me ashensor në katin e gjashtëmbëdhjetë të Institutit për Ruajtjen e Kujtimit të së Kaluarës, vendosi si punonjës i institutit kartën e vet plastike në pllakën e parashikuar për këtë qëllim dhe që ndodhej pranë hyrjes, derisa dëgjoji një shkrepje të lehtë, hapi derën e arkivit dhe hyri në mjedisin që ndodhej në ngarkim të tij: një hapësirë në trajtë kubi me ndriçim të ftohtë. Llambat e neonit, të cilat që nga tavani lëshonin një zhurmë të lehtë pune, e ndriçonin këtë hapësirë deri në këndet më të thella dhe bënë që flokët e verdhë të zonjës Kermer, të rregulluar me kujdes, të lëshonin një vezullim metalik. Flokët e kishin mbështjellë të tërën deri te bërrylat dhe, meqenëse ajo kujdesej gjithmonë që të mos i prisheshin e të mos i lëviznin, atij herë-herë i krijohej përshtypja sikur kishte përpara një përmendore, njëfarë bude mikpritës. Por në më të shumtën e rasteve ajo ngjante me atë dragoin e shpellës. Ose me rojtaren e Gralit. Nganjëherë edhe si egërsira e Buhenvaldit.

I ngriti cepat e buzëve në një mënyrë të tillë, që mund të mendohej se po vinte buzën në gaz. Madje nuk mund të mos mendohej kështu. Ai u përmbahej deri në një normave shoqërore, ndaj edhe i kishte ngritur lart cepat e buzëve, pasi kjo ishte mënyra e tij e të buzëqeshurit.

- Mirëmëngjesi, zonja Kermer, - tha ai dhe u drejtua menjëherë për nga dollapi i rrobave, ndërsa cepat e buzëve iu varën sërish poshtë në vendin e zakonshëm. Përgjigjja e saj i erdhi që prapa shpinës, teksa po varte me kujdes të madh



pallton. Mori një varëse rrobash dhe e vendosi brenda supeve të palltos në mënyrë që kjo të lëshohej poshtë barabar në të dyja krahët, pastaj e ktheu varësen në vend duke bërë kujdes që palltoja e tij të mund të varej poshtë sa më lirshëm, pa prekur në dollap dhe ca më pak te palltoja e zonjës Kermer, e cila ndodhej atje. Pastaj u përkul, mori çantën e dorës, të cilën e kishte shtrënguar ndërmjet këmbëve, e futi nën sqetullën e majtë, e shtrëngoi pas trupit, drejtoi trupin dhe shtriu me dorën e djathtë flokët. Zonja Kermer e kishte ndjekur ndërkohë me sy dhe, sapo ai nisi të ecte, i hodhi çengelën:

- Zoti Frambah! - i thirri ajo nga prapa. Ai e humbi për një çast drejtpeshimin dhe, kur ajo nisi të fliste, ai nuk e përmbajti dot veten dhe cepat e buzëve iu ngritën sërish lart. Kjo i ndodhi në mënyrë fare të vetvetishme.

- Zoti Marshner lutet të jeni i gatshëm pas orës 11 e gjysmë, sepse dëshiron të bisedonte me ju.

Frambahu tundi kokën.

- Po ai kur do të vijë? - pyeti për ta vazhduar pakëz bisedën dhe për të ulur në këtë mënyrë cepat e buzëve.

- Rreth orës njëmbëdhjetë, - u përgjigj zonja Kermer. Frambahu tundi përsëri kokën. Buzëqeshja, së cilës zonja Kermer nuk po i përgjigjej, u gdhend edhe më fort në fytyrën e tij duke i shkaktuar dhembje.

Marshneri natyrisht e dinte se nuk kishte aspak të ngjarë që atë të mos e gjeje në institut në cilëndo orë të orarit të punës, pasi gjithsesi qëndronte besnikërisht çdo ditë nga fillimi deri



në mbarim i ulur përpara tryezës së shkrimit për të futur në arkiv njërën shkresë pas tjetrës dhe më pas nuk kishte asnjë zotim tjetër, por shkonte drejt e në shtëpi. Mirëpo Marshneri ia caktonte takimet gjithnjë që më parë dhe njoftimin për to ia përcillte gjithnjë nëpërmjet zonjës Kermer. Në këtë mënyrë ai përpiqej të krijonte përshtypjen e një ngutshmërie të përgjithshme dhe të një profesionalizmi të lartë. Dhe duhet thënë se ia arrinte kësaj për bukuri.

Fytyra e zonjës Kermer me rrudha të thella mbi ballë u përkul përsëri mbi tryezën e punës. Të krijohej përshtypja se edhe puna e saj ishte kurdoherë shumë e rëndësishme, ndaj edhe përpunimi i dokumenteve të saj dukej se nuk mund të pranonte në asnjë rast as vonesën më të vogël. Ajo nuk e vuri buzën në gaz, ndërsa ai nuk e hoqi buzagazin, kështu që kur hyri në korridorin jo fort të ndriçuar, që të shpinte në zyrën e tij, u shkund një hop, si të donte ta flakte tej këtë buzëqeshje. Me të dyja duart shtrëngoi fort xhepat dhe u shkund për një kohë të shkurtër por fort, thjesht vetëm për një hop por fort ama, dhe u çlirua prej asaj buzëqeshjeje të marrë. Kjo e fundit përfundoi poshtë, në dyshemenë e errët, që ndërkohë ishte mbushur e stërmbushur me të gjitha ato buzëqeshje, me të cilat ai mbulonte mëngjes për mëngjes fytyrën përpara se të përshëndeste zonjën Kermer. Pastruesja e mblodhi këtë buzëqeshje në një kënd të korridorit, por nuk mundi ta largonte fare, pasi i mungonte pajisja e nevojshme për një gjë të tillë.



INSTITUTI I RUAJTJES SË KUJTIMIT TË SË KALUARËS ndodhet në qendër të qytetit. Ky është shumë i madh dhe shtrihet përpara në peizazhin e sheshtë, duke arritur deri tek ajo pikë ku nuk mund ta rrokë shikimi. Nuk është qytet shumë i vjetër, sikurse janë qytetet e tjera të vendit, përkundrazi, mund të thuhet se është me të vërtetë shumë i ri. E megjithatë është i mbushur me ngjarje historike. Historia kohë pas kohe e ka goditur me vare këtë qytet të madh dhe njeriu mund ta vërë re këtë, pikërisht sepse ky qytet është përpjekur vazhdimisht të flakë nga vetja, të zvogëlojë, të zhdukë gjithçka që dëshmonte për periudhat e mëparshme historike. Ky vullnet për të flakur tej, për të zvogëluar, për të zhdukur përbën tiparin e tij dallues thelbësor, sikurse e ka kuptuar me kohë një banor i tij, duke e parashikuar se i tillë do të ishte edhe fati i tij (le të shihet për këtë qëllim libri i Karl Sheflerit “Berlini. Fati i një qyteti”, Berlin-Vestend, Rajs, 1910). Qyteti e ka përmbushur këtë parashikim besnikërisht dhe në vijueshmëri. Dhe historia ka lënë pas jo vetëm fusha djerrë, por edhe ndërtesa të mëdha.

Instituti është gjashtëmbëdhjetë kate i lartë dhe njëqind e njëzet metra i gjerë. Ndërtesa e ka zanafillën nga periudha e sapombyllur e historisë. Asaj nuk iu bë një meremetim i lehtë, por një rindërtim me themel. Nëpër katet e saj të shumta ngjiten e zbresin pa pushuar gjashtë ashensorë e megjithatë nëpunësit e institutit shpesh janë të detyruar të presin gjatë përpara se të vijë ashensori dhe t’i ngjitet lart ose t’i zbresë poshtë. Në të vërtetë instituti ka një numër tepër të madh punonjësish.



Numri i tyre duhet të jetë kaq i madh, pasi edhe vetë e kaluara, me ruajtjen e së cilës ata merren, duket se është e pamatë dhe puna e tyre nuk mund të krahasohet me rrokullisjen e një guri të vetëm drejt së ardhmes, siç pat bërë dikur Sizifi, por të një mali të tërë me zhavorr.

Të gjithë ata që punojnë këtu takohen rregullisht dhe pa kurrfarë marrëveshjeje paraprake në mesin e ndërtesës, po të shihet kjo në rrafshin pingul, domethënë pikërisht në katin e tetë. Atje është vendosur mensa. Në të mund të hyhet pa përdorur kartën plastike të nëpunësit, pasi dyert e saj qëndrojnë gjithnjë hapur sikur të ftonin të hyje brenda. Ndërsa pagesa atje mund të bëhet vetëm me kartën plastike, në të cilën njeriu duhet të kalojë rregullisht shumën e parave që ka.

Makina për kalimin e vlerës së parave është një shtyllë e vogël kënddrejtë me dy fole të holla. Në njërën prej tyre futet karta plastike, në tjetrën një kartëmonedhë, të cilën makina duhet ta gëlltitë, por ajo e bën këtë si me pahir. Çdo monedhë, pavarësisht vlerës që mund të ketë, ajo e kthen mbrapsht disa herë dhe vetëm pastaj e gëlltit duke e shndërruar pa dëshirë atë gjë lëndore që i është dhënë në diçka jo lëndore me të njëjtën vlerë, sepse ajo gjithmonë i kundërvihet procesit të shndërruarit të një vlere në një vlerë tjetër, sikurse ndodh në këtë ndërtesë me atë që është e rrokshme, por që mbetet e parrokshme, e pakuptueshme. Kjo makinë e vogël është zemra e ndërtesës, e cila ndodhet në zemër të qytetit, ku rreh



zemra e historisë së shkuar dhe të ardhme të vendit, pasi ky qytet është edhe kryeqyteti i vendit. Një shndërrim i tillë i vlerave përbën diçka shumë serioze, pasi njeriu edhe mund të gabojë, ndërkohë që vlera, që është për t'u kaluar radhë pas radhe, nuk bën as të zmadhohet e as të zvogëlohet. Vlera e kartëmonedhave është e përcaktuar me saktësi, ndërsa vlera e kartave plastike jo. Ngjarjet e së kaluarës janë dokumentuar saktë, por ato nuk janë të kuptueshme. Madje edhe kur bëhen të qarta, ato përsëri mbeten të pakuptueshme.

Veprimtaria e institutit, i cili nëpërmjet hulumtimit të historisë ruan kujtimin e së kaluarës dhe në këtë mënyrë hap rrugën e së ardhmes, vërtet nuk pati një ndikim frytdhënës dhe jetik për formimin e shtetit që doli nga kjo histori, por me kalimin e kohës u bë për jetën e qytetarëve të tij po aq e domosdoshme sa edhe ajri.

Institutit ndikoi që kujtimi i krimeve të së kaluarës të bëhej me kalimin e kohës pjesë e të gjitha institucioneve të vendit. Në fillim kjo gjë eci ngadalë, por në përfundim pati një përshpejtim të vrullshëm. Dhe pasi vendi kapërceu ndarjen, e cila qe pasojë e drejtpërdrejtë e krimeve të së kaluarës, dhe u bë një vend sovran, atëherë pati mundësinë të merrej më në fund tërësisht me veten. Tani atij nuk i duhej më të jepte llogari përpara shteteve të tjera, por vetëm përpara popujve të tjerë, të cilët banonin këtu dhe nuk përbënin një institucion dhe as nuk kishin një ushtri. Ata kishin vetëm kujtimet për ato gjëra



të llahtarshme, që u ishin bërë nga tradhtarët e popullit dhe për më tepër në emër të tij, por jo nga shteti, në të cilin ky popull tani jetonte. Ata ishin plakur. Kishin mbetur edhe disa nga ata, të cilët në kohën e tyre kishin kryer krime. Edhe për ta ky ishte një kujtim i rinisë. Sepse edhe ata ishin plakur.

Në epokën e krimit pjesa më e madhe e banorëve të vendit ose nuk kishin ardhur ende në jetë ose e shumta ishin ende fëmijë. Por përbindshmëria e krimit e paraardhësve të tyre rëndonte si plumb mbi ta dhe, kur ata i afroreshin kësaj përbindshmërie, nuk prisnin tjetër veçse demaskimin e të parëve të tyre si kriminelë. Kësaj ia arrinin pa vështirësi dhe me shpejtësi të madhe, kaq i madh kishte qenë ky krim. Kaq i madh, sa ka për të vepruar deri në brezin e shtatë.

Kjo rrethanë e zbulimit të përhershëm të krimit të të parëve nuk ishte diçka e bukur, por gjithsesi ishte e nevojshme dhe, kur filloi të shihej si diçka jo më e nevojshme, u bë edhe diçka e papëlqyeshme. Atëherë shteti u kujtua për detyrën e tij kundrejt qytetarëve dhe vendosi t'ua hiqte këtë barrë, ndërkohë që shpallte se kujtimi i krimit të së kaluarës ishte një detyrë e tij e vazhdueshme. Zotimi për ta përmbushur një detyrë të tillë ishte lëndëzuar në ngritjen e përmendoreve, numri i të cilave u rrit me aq shpejtësi, sa më tepër që rritej largësia nga koha e krimit. Çdo vis, dhe të tillë kishte shumë, ku kishte ndodhur krimi, ishte kthyer në një vend përkuajtimi. Kjo kujtesë nuk u pa më si një detyrë thjesht e domosdoshme e shtetit, por si detyra më fisnike



e tij dhe nuk kishte vend pune më të nderuar se Instituti i Ruajtjes së Kujtimit të së Kaluarës, i cili qe vendosur në mes të kryeqytetit të vendit, pasi këtu, dhe kjo ishte vërtet diçka zyrtare, rrihte zemra e gjithë vendit. (Natyrisht në këtë ndërtesë ndodhej vetëm selia qendrore e institutit. Degë të tij ishin ngritur në të gjithë vendin.)

Në këtë mënyrë errësira, në të cilën ky shtet ishte zvarritur për një kohë të gjatë, kishte dalë në dritë dhe ishte ndriçuar në të gjithë thelbin e vet, gjë që ishte thjesht logjike, pasi ky institut ishte themeli i themelit të shtetit.

Këtë e dinin të gjithë.

Kjo nuk ishte më diçka e fshehtë dhe nuk mund të vihej në diskutim.

Ishte me të vërtetë thelbësorja.

Por qëkurse kjo gjë thelbësore ishte paraqitur si në tabaka dhe ishte ndriçuar nga të gjitha anët si të binte përmbi të drita e një mijë diejve, ajo nuk ishte më tërheqëse. Lufta e rrufeshme ishte kthyer në dritë të rrufeshme ndërsa realiteti i këtij krimi ishte kthyer në një histori të kohëve të vjetra.

Ai e dinte edhe këtë. Dhe në këtë rast kjo dije nuk i hynte në punë, pasi gjithsesi ai nuk mund të rrinte pa u marrë me krimin e së kaluarës.

Ishte një krim kaq i madh.

Ishte e tmerrshme, që ai krim pothuaj edhe tani vijonte të bënte keq. Kjo ishte me të vërtetë e tmerrshme, madje ishte



edhe më shumë: për të ishte thelbësorja. Çështja se ky krim, sado i madh që ishte, mund të kishte pushuar së bëri keq, çështja se e keqja e tij ishte diçka e mundshme, çështja se diçka e tillë ishte në fund të fundit e mundshme: ja, pikërisht kjo ishte e tmerrshme. Dhe nga kjo fati i tij i keq bëhej edhe më i keq.

I dukej sikur kishte mbetur jashtë kohës. Sepse një gjë e tillë vazhdonte t'i shkaktonte dhembje.



ME TË HYRË AI NË ZYRË nisi të binte telefoni. Zilja ishte vënë në tonin më të ulët të mundshëm, kështu që ajo tingëllonte kurdoherë si më të qarë, pasi askush nuk e vinte re se me sa zell e kryente telefoni detyrën e vet. E megjithatë nuk kishte ndodhur asnjëherë që ai të mos e dëgjonte zilen e telefonit. Kështu ndodhi edhe këtë radhë. Pa e lëshuar çantën nga dora ai shkoi te tryeza e punës dhe ngriti dorezën, ndërkohë që në tabelëzën e ndriçuar të telefonit pa se po i telefononte zonja Kermer.

- Urdhëroni, - tha ai.

- Para pesë minutash mori në telefon zonja Shënblum, - foli zonja Kermer.

- Urdhëroni, po ju dëgjoj, - tha përsëri ai.

- I thashë se ju mund të vinit nga çasti në çast, - shtoi zonja Kermer.

- Natyrisht, - u përgjigj ai, lëshoi dorezën, u rrotullua dhe vuri çantën e dorës në karrigen e vizitorëve që ndodhej pranë derës. Pastaj ndezi kompjuterin dhe u ul përballë ekranit për të parë vallen e madhe të gëzimit, me të cilën të gjitha stacionet televizive përshëndetnin fillimin e ditës së re të punës, duke njoftuar se veprimtaria e tyre vijonte rregullisht si deri më tani dhe në të njëjtën kohë siguronin se edhe sot do të funksiononin në mënyrë të plotë dhe pa asnjë të metë, se nuk parashikohej asnjë situatë kritike, përkundrazi do të zbatonin menjëherë secilin nga urdhrat e parashikuar tanimë, cilido që të ishte ai (gjë që ishte një gënjeshtër). Më në fund i mbetej të shihte edhe



dritarezat, ku duhej të shënonte emrin e tij si përdorues dhe fjalëkalimin e tij për të hyrë në sistem. U dëgjua përsëri zilha e trishtuar e telefonit. Në tabelëzën e ndriçuar pa numrin e Gracielës. Ngriti dorezën dhe tha: “Të marr pas pak, ende nuk e kam pirë kafënë”, dhe e uli përsëri.

Çanta e tij qëndronte si edhe më parë në karrigen e vizitorëve pranë derës, por diçka mungonte. Ai ia nguli sytë çantës dhe u përpoq të kuptonte se përse i dukej sikur atje kishte një zbrazëti të madhe. Telefoni tingëlloi zyrtë. Ishte përsëri numri i Gracielës. Ai e ngriti pak dorezën dhe e uli përsëri, pastaj e ngriti sërish, i ra numrit pesë dhe e lëshoi dorezën anash telefonit. Ai u mendua nëse pas kaq vjetësh duhej të hiqte dorë nga miqësia me Gracielën, mirëpo e kuptoi në çast se kjo ishte e pamundur, pasi pastaj nuk do të kishte më asnjëri tjetër, me të cilin të bisedonte, dhe e kuptoi më në fund se muri pranë derës së zyrës i dukej aq i zbrazët, pasi palltoja e tij nuk ishte varur aty, në vendin ku i takonte.

Zonja Kermer ia nguli sytë, sikur ta kishte pritur ardhjen e tij. Këtë radhë ai nuk i buzëqeshi asaj, por vetëm hoqi pallton nga varësja e dollapit, pastaj u rrotullua, u kthye në zyrën e tij dhe vari në varësen pranë derës pallton, e cila tani mbulonte përgjysmë shpinoren e karriges së vizitorëve. Fundi i palltos arrinte deri te ndenjësja e karriges, ndërsa çanta qëndronte në mënyrë të tillë që tani ajo e mbante pallton të shtrënguar pas shpinores dhe nuk e linte të lëvizte në çastin, kur dera hapej



dhe brenda depërtonte një rrymë ajri. Pikërisht kështu duhej të rrinte. Tanimë gjithçka ishte hëpërhë në rregull.



GRACIELA DUKEJ SI NJË PIKTURË E PIKASOS, si një nga portretet e Dora Maarit pikturuar nga Pikasoja. E megjithatë në rastin e saj nuk ishte fjala për art, por për një qenie të mbinatyrshme me madhësinë e një njeriu, qenie që, megjithatë, dukej si vepër arti.

Kishte sy të mëdhenj, hundë dhe gojë të madhe, ndërsa tiparet e fytyrës ishin vendosur në të tillë mënyrë, sa njeriu nuk mund të krijonte për to asnjë mendim, pasi ato nuk kishin mes tyre asnjë lidhje qartazi të dukshme.

Hunda vinte pakëz e pjerrët. Po ta shihje nga ana e saj, kjo pjerrësi shkonte djathtas; po ta shihje nga përballë, shkonte majtas.

Sytë sikur ishin futur poshtë ballit. Ata ishin bojë hiri si në blu.

Goja e saj e madhe pothuaj ishte pa ngjyrë dhe binte në sy vetëm kur ajo fliste. Në ato çaste ajo dukej si një formë e ndërtuar disi ndryshe rreth një vrime që lëviz në mes të fytyrës. Kur Graciela nuk fliste, goja e saj humbiste në atë tërësi të palatuar, që i shërbente si fytyrë.

Ai kishte menduar gjatë për fytyrën e Gracielës, atëherë kur sapo ishte njohur me të, pasi nuk dinte të thoshte nëse ajo ishte shumë e shëmtuar apo ishte një bukuri më vete. Asokohe, sa herë takohej me të, ai nuk ia ndante sytë dhe po kështu bënte edhe ajo, kur i tregonte për anët e ndryshme të vuajtjeve të saj nga e kaluara naziste e Gjermanisë. Njëherë, kur ata shkuan së bashku në një koncert simfonik (në program ishin: Ludvig van Betoven, simfonia n.1 në do mazhor, op. 21, botim i Xhonathan del Marit; Anton Vebern, Gjashtë pjesë për orkestër, op. 6 b, përmbledhur në vitin 1928; Ludvig van Betoven, simfonia n.7



në la mazhor, op. 92, botim i Xhonathan del Marit), ai për herë të parë vuri re që ajo kishte bërë tualet (ndërkohë ajo ishte njohur me Joakimin). I kishte ngjyer buzët me një të kuq ngjyrë gjaku, sytë i kishte shkruar me laps, ndërsa qerpikët i kishte lyer me rimel. Në këtë mënyrë i kishte dhënë fytyrës një pamje shumë shprehëse, ndërsa hunda e madhe në mes të saj mund ta gabonte vëzhguesin, meqenëse dilte nga fytyra pa u futur kurrë ndonjëherë më parë në të.

Ah, sikur gjithkush të kishte një hundë të tillë!

Numri i shkronjave të emrit të saj për fat nuk mund të ndahej në tresh. Ai përpigëj kurdoherë në mënyrë të vetvetishme ta bënte diçka të tillë, sa herë që mendonte për të, mirëpo asnjëherë nuk ia dilte mbanë. Vetëm së bashku me mbiemrin numri i shkronjave të emrit bëhej i plotpjesëtueshëm me tre dhe kjo gjë e qetësonte. Ndërkaq ai nuk mund ta lidhte gjithë kohën emrin e saj me mbiemrin, pasi i dukej sikur të ishte duke kujtuar emrin e ndonjë shturmbanfyrieri¹ të ndonjë dosjeje. Për të ajo kishte vetëm emrin, i cili për fat të keq kishte tetë shkronja dhe teta nuk pjesëtohet me tre, këtë nuk e luante as topi. Vetëm në rasën gjinore kjo ishte e mundur, por në këtë rast ai ishte i detyruar të gjente diçka, që e vinte emrin e saj në gjinore dhe në të njëjtën kohë ishte edhe për vete i pjesëtueshëm

¹ Në kohën e nazizmit gradë në trupat SA dhe SS e ngjashme me majorin (të gjitha shënimet janë të përkthyesit).



me tre. Fjalët “*Augen*”, “*Nase*”, “*Mund*” nuk vlenin për këtë qëllim. Kurse fjala “*Lippen*”¹ shkonte. Për këtë arsye *buzët e Gracielës* i sillnin kënaqësi, pasi ato ishin pesëmbëdhjetë shkronja, numër i parapëlqyer shkronjash për të, pasi po të ndahej në tresh, atëherë herësi dilte pesë. Kjo ishte diçka e rregullt, diçka që shkonte dhe nuk kishte si të ishte ndryshe: pesëmbëdhjetë pjesëtim për tre baras pesë dhe pesë herë tre baras pesëmbëdhjetë. Diçka e plotë, e përfunduar.

Sa herë që kishte të bënte me njerëz, emri i të cilëve nuk plotpjesëtohej me tre, ai provonte menjëherë vështirësi në bisedë me ta. (Zonja Kermer, emri i së cilës ishte Elisabetë, përbënte gjithsesi një përjashtim. Por ndoshta kjo vinte, ngaqë ai nuk i fliste asnjëherë me emër, por vetëm “zonja Kermer”. Kjo bënte që pjesëtimi me tre të mos përmbushej dhe kësisoj zonja Kermer nuk i ngjallte kurrfarë simpatie.)

Në të vërtetë njeriu, të cilin mundemi ta shohim për një kohë të gjatë pa e kuptuar se çfarë po shohim, nuk është i shëmtuar. Por as i bukur nuk është. Në të tilla raste njeriu nuk të duket as i bukur dhe as i shëmtuar. Një fytyrë si ajo e Gracielës është përtej çdo mundësie për t’u përshkruar nga ana estetike. Por ai e kishte ndarë mendjen ta quante fytyrën e saj të bukur njëlloj si edhe trupin, i cili nuk të kujtonte aq një pikturë të Pikasos sa të Boteros, ashtu i mbushur dhe i rrumbullakët siç ishte dhe i madh si gjithçka tjetër e saj,

¹ Përkatesisht “sytë”, “hunda”, “goja”, “buzët” në gjuhën gjermane.



ndërsa gjinjtë dukeshin si dy xhumba të mëdha në gjithë këtë masë mishi të gjallë, të cilën ajo e lëvizte dhe e shpinte gjithandej.

Në trupin e bëshëm të Gracielës mund të jetohej për bukuri, pasi në të kishte vend sa të duash për të gjitha gjendjet e mundshme shpirtërore, që mund të shtriheshin atje si mbi jastëk pa ndier kurrfarë dhembjeje. Mirëpo për Gracielën, e cila teorikisht do të duhej të kishte kontroll të plotë mbi trupin e saj, nuk ishte kështu, përkundrazi. Ajo vetë nuk e shihte veten me sytë e një njohësi të artit, përkundrazi mendonte se fytyra e saj ishte e shëmtuar, ndërsa trupi - i dhjamosur. Ajo ishte si Republika e vjetër Federale Gjermane.

Të lumtur, ose të paktën kështu iu duk asaj, ajo e ndjeu veten vetëm atëherë kur dikush tjetër shfaqti interes për vlerën e trupit të saj. Ky njeri quhej Joakim. Ai nuk shfaqti interes për trupin e saj, si mund të bënin shumë të tjerë (në të vërtetë i tillë ishte), por u entuziazmua prej tij, pasi ky trup, kur e krahasoi me të vetin, i ngjallte pa dyshim kënaqësinë më të madhe, gjë që për më tepër shoqërohej me bindjen e patundur se kjo kënaqësi shumë shpejt do të plotësohej. Ai i përsëriste vazhdimisht Gracielës, zotërueses dhe banueses së këtij trupi, se ç'trup të bukur kishte dhe, meqenëse Graciela deri atëherë nuk kishte takuar asnjeri që të ishte shprehur me aq fjalë të mira për trupin e saj, ia kishte vënë këtë menjëherë në dispozicion të plotë, që do të thotë se i kishte lejuar në mënyrë të përkohshme dhe



konkrete një përdorim të pakufizuar të vetes, për më tepër kishte filluar të merrej ngrohtësisht me pamjen e vet të jashtme.

Qëkurse trupi i saj ishte bërë i lakmueshëm për Joakimin, ajo kishte nisur të shihej sërish në pasqyrë dhe ndërkaq nuk i shkonte më mendja te mbajtja e dietës, përkundrazi përpiquej të përfytyronte se ku përqendrohej shikimi i tij. Ajo përsëri nuk arrinte të gjente asgjë të bukur në trupin e vet, por meqenëse ky për Joakimin ishte i bukur, ajo ishte të paktën e kënaqur për trupin që kishte. Gjithsesi ajo nuk kishte pasur asnjë të dashur përpara tij. Tani ajo nuk e gjykonte fytyrën e vet sipas normave estetike të kohës, por bënte përpjekje të gjalla për të rritur fuqinë e saj tërheqëse duke bërë rregullisht tualet dhe duke u përkujdesur shumë e me merak të madh për trupin për ta mbajtur kurdoherë të gatshëm për përdorim. Ajo lahej dendur dhe lyhej me kremra të shtrenjtë, i pastronte këmbët me brisk edhe në dimër, shkonte rregullisht te floktarja, kishte nisur të hante çokollata pa u shqetësuar, veç kësaj i përdorte perimet më shumë se përpara, po kështu pinte shumë litra ujë, me qëllim që përbërja e trupit të mbetej sa më e shëndetshme dhe më e freskët. Natyrisht, tani që dikush e dëshironte trupin e saj, ai ishte bërë i rëndësishëm. Marrëdhënia ndërmjet sekseve të ndryshme në lidhjen e saj me Joakimin ishte tkurrur deri në thelbin e vet, deri në atë që ishte thelbësore sipas mendimit të Graciелës, e cila veç kësaj besonte se kjo



tkurrje e skajshme e marrëdhënies deri te thelbi i saj ishte në të vërtetë zgjerim dhe mbushje e saj në masën më të plotë.

Dashuria e tyre qëndronte vetëm e vetëm në faktin që bëheshin një trup i vetëm dhe asgjë më shumë. Ajo nuk dallohej për asnjë veçori tjetër jotrupore, për asgjë që e bën të veçantë herë pas here një njeri, por dallohej vetëm e vetëm nëpërmjet veçorisë - në të vërtetë më se të rëndomtë - të gjinisë, vetëm nëpërmjet kësaj shenje të qartë sa më s'ka, ndërsa të gjitha tiparet e tjera dalluese shiheshin si të papërfillshme. Vetëm një gjë kishte rëndësi: të qenët femër. Dhe të këndoje së bashku me Keroll Kingun, ca më mirë me Areta Frenklinin:

*Ju më bëni të ndihem,
ju më bëni të ndihem,
ju më bëni të ndihem
me të vërtetë grua,*

njërën nga këngët e suksesshme më banale që mund të bëhen.

Dashuria e tyre qëndronte në faktin që ajo përmbledhej vetëm te kjo veçori, e cila në të vërtetë nuk përbën kurrfarë veçorie. Këtu e veçanta qëndron vetëm te rrëgjimi i marrëdhënies.

Hansi nuk i dinte edhe aq mirë të gjitha, por kjo mund të merrej me mend, pasi ai e kishte provuar sesi kishte ndryshuar



ajo në mënyrë të papritur, qëkurse në jetën e saj kishte hyrë Joakimi. Atij nuk i kishte shpëtuar pa vënë re sesi kujdesej tani ajo për veten, sesi vishej në mënyrë elegante, sesi tani flokët e saj ishin kurdoherë të posalarë, si kundërmonthe nga parfumi dhe si fliste më shumë për çështjet e një gruaje shtëpiake sesa për Aushvicin. Kur Graciela vishte ende xhinse e bluza pambuku dhe ata flisnin ende për Aushvicin, ai kishte menduar se ajo e kuptonte fatin e tij të keq, pasi ajo merrte pjesë në një fat të tillë. Për këtë arsye edhe kishin lidhur miqësi. Lidhur me fatin e saj, ngushtësisht të saj, të keq ata nuk kishin biseduar në mënyrë të drejtpërdrejtë, meqenëse ky fat ishte fare i shpërfillshëm në krahasim me atë fatkeqësi pafundësisht të madhe, për të cilën ata vazhdimisht flisnin. Kështu ishte përpara se ajo të kthente fletë dhe të besonte se tanimë ishte e lumtur, meqenëse mund të gëzonte një të ashtuquajtur lidhje dashurie.

Këtë Joakimin, emri i të cilit jo vetëm që nuk mund të plotpjesëtohej me tre, por shtatë shkronjat e të cilit ishin në tërësi numri më i papëlqyeshëm që mund të bëhej, edhe sikur të mund të plotpjesëtohej me tre, këtë Joakimin, pra, ai e kishte takuar vetëm pak herë dhe gjithmonë kalimthi, kur ishte ndodhur te pragu i derës gati për të hyrë brenda, ndërkohë që tjetri matej të dilte. Në këto raste Gracielen e kishte gjetur kurdoherë të shkrehur, ndërsa Joakimi dukej shend e verë. Dhe Hansit mend i vinte për të vjellë, prandaj bënte çmos që të mos e takonte Joakimin. Një herë i qëlloi të takohej me të,



teksa për vete ishte duke dalë, dhe kjo e bëri të ndihej deri diku i lënduar. Kur ata linin takim me Gracielen në shtëpi të saj, ai kurdoherë e pyeste nëse ajo e kishte lënë me Joakimin të takoheshin më parë ose më pas po aty, dhe nëse ishte kështu, atëherë ai vinte ose shumë më vonë ose largohej shumë më herët ose i propozonte asaj të takoheshin në një ditë tjetër.



AI MORI IBRIKUN E KAFES NGA DOLLAPI, ku e vendoste çdo mbrëmje pasi e shpëlante, dhe mbylli derën, kur hyri në këndin e çajit, ku mbi pllakën e sobës ndodhej, tanimë e zier, kafeja ekspres e përgatitur nga zonja Kermer. Dyert e tjera ishin hapur dhe përmes tyre dukeshin dhomat e zbrazëta. Kandidatja për doktoraturë ishte në bibliotekë dhe atë çast nuk ndodhej atje asnjëri prej praktikantëve, ndërsa Marshneri vinte në orën njëmbëdhjetë. Në arkiv ishte qetësi e plotë. Dera e zyrës së kompjuterave në fund të korridorit ishte e mbyllur.

Pikërisht zyra e kompjuterave ishte gjëja thelbësore e arkivit të Institutit të Ruajtjes së Kujtimit të së Kaluarës. Ajo ishte njëfarë prapadhome e arkivit, ku lidheshin ndërmjet tyre arkivat e shumtë të shërbimit dhe ku mundësohej një shërbim i përqendruar për të gjithë arkivat e tjerë që nevojiteshin për ruajtjen e kujtimit të së kaluarës si dhe për aktet e ruajtura në to. Vetë arkivi ishte i vockël dhe përmbante vetëm materiale të gjetura kohët e fundit, fonde të pahapura, objekte të rralla. Puna e Frambahut në të vërtetë nuk ishte veçse një hije e veprimtarisë së vërtetë arkivore, një lloj zbukurimi, prej të cilit njeriu nuk donte të ndahej për arsye malli, ishte një mënyrë e ruajtjes së kujtimit të së kaluarës. Ai nuk kishte asnjë lidhje me punonjësit e zyrës së kompjuterave. Ata sikur jetonin në një planet tjetër dhe mund t'i shihte vetëm kur shkonte në pikën e pushimit të drekës, kohë të cilën ata e kalonin kurdoherë së bashku



dhe pa asnjë tjetër. Por ata shfaqeshin e bëheshin konkretë në mënyrë të menjëhershme dhe të padiskutueshme, sa herë që ai do të kishte ndonjë problem me kompjuterin e tij. Ia zgjidhnin problemin brenda dy minutash, i përgjigjeshin falënderimit të tij me një përbuzje të lehtë dhe ktheheshin sërish te kompjuterat e tyre të mëdhenj. Praktikisht ai ndodhej vetëm me zonjën Kermer.

E zbrazti ajkën e trashë, të pasterizuar dhe të ëmbël të kafesë nga ibriku i vogël, që ndodhej në tryezën e tij të punës, në filxhanin e kafesë dhe mori në telefon Gracielen, e cila e ngriti menjëherë dorezën përpara se ai të dëgjonte që të binte qoftë edhe një herë zilja.

- Ah, Hans, - i tha ajo, - më vjen me të vërtetë shumë keq, por më duhet ta kthej mbrapsht takimin e lënë për sonte në mbrëmje.

Ai shtrëngoi buzët me njëra-tjetrën dhe fytyra i mori një pamje të tillë, që fare pak dallonte nga buzëqeshja. Pastaj i lëshoi sërish buzët dhe nga thellësia e grykës i doli mbytur fjala “Joakimi”.

- Po. Papritur Joakimi ishte i lirë për sonte dhe unë kam një javë pa u parë me të.

- Ah, po! - tha ai dhe u kujtua që kishte plot dy javë pa u takuar me Gracielen.

Për një çast ra heshtja.

- Mirë, - tha ai pastaj. - Ose, jo mirë. Por flasim më vonë, se tani kam punë.



- E kuptoj, - tha ajo. - Më vjen vërtet keq.

- Nuk ka gjë, - tha ai. - Pafshim! - Dhe uli dorezën.

Nga jashtë ndiente të ftohtë, nga brenda ndihej i zbrazët. Ua nguli sytë dy dritarezave po ashtu të zbrazëta në ekranin e kompjuterit. Në grykë ndiente diçka të trashë që nuk dëshironte ta gëlltiste. Shtypi “hafram” në dritarezën e sipërme dhe “hoess” në të poshtmen. Programi i posaçëm i arkivit e përshëndeti dhe ai mori fletën e parë nga kutia e kartonit me trashëgiminë e Zigfrid Volkenkrautit për ta futur në bazën e të dhënave kërkimore.

*RELACION**PËR QËNDRIMIN TIM**NË DISA KAMPE PËRQËNDRIMI*

*Në fund të janarit
të vitit 1943
mua më dërguan
nga Terezzienshtadi
në Aushvic-Birkenau.*

*Në Terezzienshtad
unë së bashku me prindërit
kam jetuar plot një vit.*

*Prindërit e mi
u dërguan në Aushvic
vetëm në tetor 1944
dhe këtu
u vranë menjëherë
në dhomat e gazit.*

*Unë për vete,
pasi mbërrita në Aushvic,
iu nënshtrova një kontrolli,
nga i cili dola i aftë për punë,*



*prandaj edhe nuk më dërguan
menjëherë në dhomat e gazit
për të më vrarë.*

*Edhe kontrollet e mëvonshme
në kamp i kalova,
po kështu edhe
marshimin e vdekjes
për zëbrazjen e Aushvicit
duke nisur nga dhjetori 1944,
kur arrita në kampin
e Bergen-Belsenit.*

*Atje në prill 1945
na çliruan trupat britanike.
Sot unë jetoj
në fshatin Imbshausen,
që ndodhet në Saksoninë e Poshtme
në afërsi të Northeim-it.*

*Punoj si argat
në një fermë.*

*Jam litograf
dhe poet.*



FLETA NUK KISHTE DATË. Ishte e dyzetegjashta me këtë tekst. Frambahu vuri vulën e institutit mbi të dhe shkroi numrin e arkivit në rreshtin përkatës të vulës. Pastaj shtypi numrin në tabelën e shfaqur në ekranin e kompjuterit dhe shkroi aty pranë në shtyllën “Titulli”: “Relacion për qëndrimin tim në disa kampe përqendrimi”, në shtyllën “Lloji i dokumentit”: “relacion”, në shtyllën “vëllimi”: “1 fletë, 1 faqe”, në shtyllën “përshkrimi”: “gjendje e mirë, shtypur me makinë shkrimi, numri, data”, në shtyllën “vërejtje”: “rreshta shumë të përthyer”.

Kishte edhe variante me shkrim dore të këtij relacioni. Për sa i takon përmbajtjes variantet nuk kishin asnjë shmangie mes tyre, por kishte nga ata që nuk e kishin një përthyerje të tillë të rreshtave dhe vinin pothuaj si në prozë, sikurse kishte edhe të tillë si ky varianti këtu, të cilët i kishin rreshtat të përthyer si në poezi. Meqenëse Volkenkrauti nuk e kishte datuar këtë relacion, nuk mund të thuhet me saktësi nëse ai i kishte thyer edhe më tej me kalimin e kohës rreshtat apo me kalimin e kohës kishte arritur të shkruante me rreshta të pandërprerë.



PËR NJË KOHË TË GJATË MENDOHEJ SE TRASHËGIMIA E VOLKENKRAUTIT kishte humbur. Mirëpo për një gjë të tillë nuk e kishte ngritur shqetësimin askush nga punonjësit e Institutit të Ruajtjes së Kujtimit të së Kaluarës a ndonjë tjetër, pasi dëshmitë e pakta të aftësive të veta, që ai kishte shfaqur gjatë jetës së tij të shkurtër, nuk kishin qenë as të bujshme dhe as premtuese. Përveç një vëllimthi të hollë me poezi të vitit 1951 (“me tri ilustrime të autorit”) si dhe dy studimeve të shkurtra, të cilat ishin botuar po atë vit në një gazetë krahinore të Saksonisë së Poshtme, nuk kishte botime të tjera dhe litografitë e tij ishin paraqitur në publik vetëm një herë, në një galeri në Gëtingen, të mbyllur tanimë prej kohësh, gjë që përmendej në një katalog. Në mars të vitit 1953 Zigfrid Volkenkrauti mbeti i shtypur nga një traktor në Imbshausen pranë Northeim-it dhe u varros në vendin e fatkeqësisë. Ai ishte njëzet e nëntë vjeç dhe la pas gruan me një vajzë. Sesi shkoi fati i tyre askush nuk u interesua deri ditën që në institut mbërriti kutia me trashëgiminë e tij. Kishte shumë mundësi që as bashkëshortja e Volkenkrautit nuk jetonte më, ndryshe kutinë do ta kishte mbajtur ajo. Dhe mundet që të kishte mbetur në jetë vetëm vajza e quajtur Mafalda, e cila nuk la tjetër njeri pas vetes atë ditë që u hodh nga ballkoni i banesës së saj në katin e dymbëdhjetë në qytetin e Shvajnfurtit. Përpara këtij akti ajo kishte lënë përmbi kuti një pusullë me lutjen që kutia të dërgohej në Institutin



e Ruajtjes së Kujtimit të së Kaluarës. Asgjë tjetër. Asnjë sqarim, asnjë letër lamtumire, sikurse bëhej e ditur në letrën e shoqërimit, që kishte hartuar trupi gjykues mbi çështjen e trashëgimisë.